

20150250621

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 1

Në Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13 dhe 177/14) pas nenit 12 shtohet titulli i ri dhe neni i ri 12-a, si vijojnë:

"Shfrytëzimi i të dhënave"

Neni 12-a

(1) Për qëllimet e regjistrave dhe bazave të të dhënave nga neni 10 paragrafi 1 të këtij ligji, Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi të Ujërave në formë elektronike posedon të dhëna të caktuara gjeografike si ortofotokarta të përpunuara në bazë të incizimit të realizuar prej ajrit në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe model digjital të terrenit, të cilat mund të shfrytëzohen nga organe të interesuara, organizata dhe subjekte tjera me kompensim.

(2) Organet e administratës shtetërore të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni i shfrytëzojnë pa kompensim për nevoja zyrtare.

(3) Nëse organet e administratës shtetërore shfrytëzimin e të dhënave e kërkojnë për nevoja të subjekteve tjera – persona të tretë, për shfrytëzimin e tyre janë të obliguara të paguajnë kompensim.

(4) Lartësia e kompensimit për dërgimin dhe shfrytëzimin e të dhënave përcaktohet varësisht nga lartësia e shpenzimeve reale që janë bërë për përpunimin e të dhënave, lloji, forma, sasia e të dhënave dhe kritere tjera.

(5) Mënyrën e dërgimit, shfrytëzimit, ruajtjes së të dhënave, si dhe lartësinë e kompensimit për shfrytëzimin e të njëjtave e rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të Ministrisë të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave".

Neni 2

Në nenin 14 paragrafët (2) dhe (3) ndryshohen si vijojnë:

"(2) Shfrytëzuesit e mjeteve nga programi për mbështetje financiare në bujqësi dhe programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural duhet t'i kenë shlyer të gjitha detyrimet financiare të përcaktuara në nenin 14-a paragrafi (2) të këtij ligji.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni shfrytëzuesit e mjeteve nga programi për mbështetje financiare në bujqësi dhe programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural që kanë detyrime të pashlyera, e të maturuara të përcaktuara në nenin 14-a paragrafi (2) i këtij ligji, të njëjtat duhet t'i shlyejnë në kushte dhe mënyrë të përcaktuara me nenin 14-a të këtij ligji."

Neni 3

Titulli para nenit 14-a dhe neni 14-a ndryshojnë si vijojnë:

"Shlyerja e detyrimeve

Neni 14-a

(1) Shfrytëzimi dhe pagesa e mjeteve nga programi për mbështetje financiare në bujqësi dhe programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural bëhet pasi do të zbatohet procedura për shlyerjen e detyrimeve të papaguara, e të maturuara të shfrytëzuesit të mjeteve nga shuma e mbështetjes financiare të miratuar.

(2) Detyrimet financiare të shfrytëzuesit të mjeteve janë sipas bazave në vijim:

- detyrime në bazë të qirasë për shfrytëzimin e tokës bujqësore shtetërore;
- detyrime në bazë të qirasë për shfrytëzimin e kullosave shtetërore;
- detyrime në lidhje me kompensimin e ujit;
- detyrime në bazë të koncesionit të peshqve për peshkimi afarist dhe rekreativ;
- detyrime në bazë të koncesionit për dhënie të gjahut në vendet për gjueti në shfrytëzim;
- detyrime në bazë të marrëveshjeve të lidhura për shfrytëzimin e mjeteve nga fondet e kompensimit nga ndihma e huaj për të cilat është kompetente ministria dhe
- detyrime në bazë të tatimeve dhe kontributeve për të cilat është kompetente Drejtoria e të Hyrave Publike.

(3) Detyrimet financiare të papaguara e të maturuara nga paragrafi (2) i këtij neni shlyhen përmes Agjencisë.

(4) Agjencia në procedurën për pagesë të mbështetjes financiare të miratuar e mban shumën e detyrimeve financiare të papaguara, e të maturuara nga paragrafi (2) i këtij neni dhe e bartë në llogari të subjektit kompetent për përcaktimin dhe arkëtimin e kërkesës përkatëse.

(5) Detyrimet financiare të papaguara, e të maturuara nga paragrafi (2) alinetë 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni përcaktohen me gjendjen më 15 janar në vitin për të cilin realizohet e drejta e mbështetjes financiare.

(6) Detyrimet financiare të papaguara, e të maturuara nga paragrafi (2) alineja 7 të këtij neni përcaktohen me gjendjen në ditën kur është miratuar shuma e mbështetjes financiare për pagim.

(7) Mënyrën, subjektet, evidencën, procedurën për shlyerje të detyrimeve financiare nga shuma e mbështetjes financiare, mënyrën dhe formën e shkëmbimit të të dhënave dhe pagesën e mbështetjes financiare i rregullon Qeveria me propozim të ministrit për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi të Ujërave dhe ministrit të Financave.”

Neni 4

Në nenin 21 paragrafi (1) pas alinesë 8 shtohet aline e re 9, si vijon:

“- një përfaqësues nga shoqata e themeluar për avancimin e turizmit rural.”

Neni 5

Neni 66 ndryshohet si vijon:

“Trajnimi dhe informimi i prodhuesve bujqësorë

Neni 66

(1) Ndihma për trajnim të prodhuesve bujqësorë është e dedikuar për organizim dhe mbajtje të trajnimit profesional për fitimin e shkathtësive dhe sesioneve informative për përsosje dhe aftësim të prodhuesve bujqësorë, nëpërmjet mbajtjes së kurseve, seminareve, ligjëratave, ndjekjeve të ekonomive bujqësore dhe pyjore, punëtorive dhe mësimi individual, veçanërisht për fushat:

- organizim i suksesshëm dhe menaxhim i ekonomisë bujqësore;
- vendosje e veprimtarive shtesë në ekonominë bujqësore;
- vendosje dhe përdorim i arritjeve bashkëkohore teknologjike dhe praktikave inovative;
- transferim i diturive për rezultate të arritura shkencore-hulumtuese;
- shfrytëzim i teknologjive informatike për prodhimin bujqësor;
- zbatim i standardeve të përcaktuara nga fusha e mbrojtjes së mjedisit jetësor, mbrojtjes dhe shëndetit të njerëzve, mbrojtjes dhe shëndetit të bimëve, mbrojtjes së shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve dhe zbatim i praktikave higjienike;
- zbatim i masave për mbështetje të kryerjes së praktikave prodhuese bujqësore për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe rajoneve rurale dhe

- vendosje e prodhimtarisë bujqësore me zbatim të standardeve më të larta për cilësi.

(2) Ndihma nga paragrafi (1) i këtij neni nuk është e dedikuar për kurse të cilat financohen në suazat e arsimit të rregullt dhe të cilat nuk janë të dedikuara për bujqësinë dhe pylltarinë.

(3) Shfrytëzues i përkrahjes është dhënësi i trajnimit ose i formave tjera të transferimit të diturisë dhe aktiviteteve për informim.

(4) Përkrahja nga paragrafi (1) i këtij neni është dedikuar për ekonomitë bujqësore të cilat janë të regjistruara në RVEB.

(5) Përkrahja nga paragrafi (1) i këtij neni jepet në lartësi prej 100% të vlerës së shpenzimeve të pranueshme për organizim dhe zbatim të trajnimit përkatësisht informimit si dhe shpenzime për udhëtim dhe akomodim, përpunim dhe printim të programeve, materialeve arsimore, broshurave për sesionet informative, shpenzime për organizim dhe zbatim të trajnimeve dhe sesioneve informative, kompensim për ligjërues dhe kompensim të shpenzimeve ditore dhe për udhëtim të pjesëmarrësve.

(6) Vlera e përgjithshme e shpenzimeve të pranueshme përkufizohet në pajtim me numrin e planifikuar të pjesëmarrësve të trajnimeve ose sesioneve informative dhe paguhet pjesërisht ose pas realizimit të plotë të trajnimeve ose sesioneve informative në bazë të numrit real të pjesëmarrësve.

(7) Llojin e aktiviteteve dhe temave të cilat janë lëndë e përkrahjes, shqyrtimin detal të shpenzimeve të pranueshme, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për ndarjen e përkrahjes, kriteret për zgjedhje të shfrytëzuesve, kushtet që duhet t'i plotësojnë shfrytëzuesit i përcakton ministri.

(8) Mënyrën për realizimin e përkrahjes nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton drejtori i Agjencisë pas mendimit pozitiv të marrë nga Ministria.”

Neni 6

(1) Rregullat nënligjore nga nenet 12-a dhe 14-a të këtij ligji do të miratohen në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13 dhe 177/14).

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".